



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI**

U R D H Ë R

Nr.78, datë 17.4.2019

PËR

**CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR
PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE NË FUSHËN E NJOHJES
SË LEJEVE TË DREJTIMIT TË AUTOMJETEVE PËR SHTETASIT
SHQIPTARË JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “d”, të nenit 28, të Ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit nr. 510, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Diasporën” dhe të vendimit nr.504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin e zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli si koordinator shtetëror për ndjekjen e procesit të negocimit të marrëveshjeve dypalëshe shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit.
2. Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjës për koordinimin ndërinstitutional për negociimin e marrëveshjeve shtetërore deri në nënshkrimin e tyre.
3. Për këtë proces raportohet me shkrim çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij urdhri.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A